



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVA – PREDSIEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES  
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr.03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik;

**D e k r e t o j**

Ratifikimin e Marrëveshjes për Transferimin e Personave të Dënuar, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar me 08 prill 2011, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 06 maj 2011.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-009-2011

Prishtinë, më 09 qershor 2011

  
Atifete Jahjaga  
Presidentë e Republikës së Kosovës

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET**

**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**DHE**

**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

**PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR**

**PREAMBULA**

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë; këtu e tutje të referuara si "Palët";

Në aspiratat e tyre për zhvillim të mëtutjeshëm dhe fuqizimin e marrëdhënieve bilaterale në frymën e miqësisë ekzistuese dhe në bashkëpunimin sa i përket transferimit të personave të dënuar ndërmjet dy shteteve;

Duke marrë parasysh dëshirën për pjesëmarrje aktive në procesin e bashkëpunimit në integrimin Evropian;

Pajtohen si vijon:

## Neni 1 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, shprehjet kanë këtë kuptim.

1. “dënim” do të thotë çdo dënim apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë, të vendosur nga një gjykatë për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar si rezultat i një veprë penale;
2. “vendim” është çdo vendim ose urdhër i gjykatës që shpall një dënim;
3. “Palë dënuese” është shteti në të cilin është shqiptuar dënimi për personin, i cili mund të transferohet ose është transferuar;
4. “Palë zbatuese” është shteti në të cilin personi i dënuar mund të jetë ose është transferuar për të vuajtur dënimin e tij.

## Neni 2 Parime të përgjithshme

1. Palët angazhohen t’i ofrojnë bashkëpunim të gjerë në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje.
2. Një person i dënuar në territorin e një Palë mund të transferohet në territorin e Palës tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje, për të vuajtur dënimin që i është shqiptuar kundër atij/asaj. Për këtë qëllim ai/a jo mund të shprehë interesin e tij/saj tek Pala dënuese ose tek Pala zbatuese për transferimin e tij në përputhje me këtë Marrëveshje.
3. Transferimi mund të kërkohet si nga Pala dënuese ose ajo zbatuese.

## Neni 3 Kushtet për Transferim

1. Në përputhje me këtë Marrëveshje një person i dënuar mund të transferohet vetëm sipas kushteve në vijim:
  - 1) nëse personi i dënuar është shtetas i Palës zbatuese;
  - 2) nëse vendimi është i zbatueshëm;
  - 3) nëse në kohën e pranimit të kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë (6) muaj të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i pacaktuar;
  - 4) duke marrë parasysh moshën e tij/saj ose gjendjen e tij/saj fizike apo mendore dhe, kur njëra prej të dy Palëve e konsideron atë si të nevojshme, pëlqimi për transferim të personit të dënuar duhet të merret nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij/saj;
  - 5) nëse veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë një veprë penale në përputhje me të drejtën e Palës zbatuese ose do të përbënte një veprë penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe
  - 6) nëse Pala dënuese dhe zbatuese janë dakord me transferimin.

2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha e kryerjes së dënimit nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1.3.

#### **Neni 4 Obligimi i dhënies së informatave**

1. Çdo person i dënuar ndaj të cilit mund të zbatohet kjo Marrëveshje duhet të informohet nga Pala dënuese mbi përmbajtjen (lëndën) e kësaj Marrëveshje.
2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes Palës dënuese për t'u transferuar në përputhje me këtë Marrëveshje, ajo Palë njofton Palën zbatuese sa më shpejt që të jetë e mundur pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.
3. Informacioni duhet të përmbajë:
  - 1) emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
  - 2) shtetësinë dhe përkatësin etnike të personit të dënuar;
  - 3) adresën e tij/saj, nëse ka, në territorin Palës zbatuese;
  - 4) një deklaratë përshkruese të fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi; dhe
  - 5) natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit.
4. Nëse personi i dënuar e ka shprehur interesin e tij/saj tek Pala zbatuese, Pala dënuese me kërkesë do t'i komunikoj asaj Pale informacionin e përmendur në paragrafin 3 të mësipërm.
5. Personi i dënuar informohet me shkrim dhe në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton për çdo veprim të ndërmarrë nga Pala dënuese ose zbatuese në përputhje me paragrafin e mësipërm, si edhe për çdo vendim të marrë nga secila nga palët lidhur me kërkesën për transferim.

#### **Neni 5 Kërkesat dhe përgjigjet**

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.
2. Kërkesat do të adresohen nga Ministria e Drejtësisë së Palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë së Palës së kërkuar. Përgjigjet do të përcillen nëpërmes të kanaleve njëjta.
3. Pala kërkuese duhet të informojë Palën e kërkuar për vendimin e saj nëse është pajtuar apo jo me kërkesën për transferim.

#### **Neni 6 Dokumentet mbështetëse**

1. Pala zbatuese me kërkesë të Palës dënuese do të siguroj:
  - 1) Dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i asaj Pale;

2) Një kopje të ligjit përkatës të Palës zbatuese e cila parashikon që kryerja apo moskryerja e një veprimi për të cilin është dhënë dënimi në Shtetin dënues përbën një veprë penale në pajtim me ligjin e Palës zbatuese apo do të përbente një veprë penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij.

2. Nëse bëhet kërkesë për transferim, Pala dënuese i paraqet dokumentet e mëposhtme Palës zbatuese, përveç nëse njëra prej Palëve ka bërë të ditur se nuk është dakord me transferimin:

1) një kopje të vërtetuar të aktgjykimit dhe të ligjit mbi të cilin bazohet aktgjykimi;

2) një deklaratë ku tregohet se sa kohë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë informatat për ndalimet paragjyqësore, shkurtimet e dënimeve, si edhe për çdo dokument tjetër relevant që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit, siç është përfitimi i besimit për punën e kryer si dhe për sjellje të mirë;

3) një deklaratë e cila përmban pëlqimin për transferim siç parashihet në nenin 3, 1,4;

4) kurdo që është e nevojshme, ndonjë raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar informacione për trajtimin e tij/saj në Palën dënuese dhe ndonjë rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në Palën zbatuese.

3. Secila Palë mund të kërkojë të pajiset me çfarëdolloj dokumenti ose deklaratë të përmendura në paragrafin 1 ose 2 të mësipërm para se të bëjë kërkesën për transferimin ose para marrjes së vendimit për rënien dakord për transferimin e tij ose jo.

#### **Neni 7**

##### **Pëlqimi i personit të dënuar**

1. Pala dënuese sigurohet që personi i kërkuar për të dhënë pëlqimin për transferimin në përputhje me nenin 3.1.4 e bën këtë me vullnetin e tij dhe me dije të plotë për pasojat ligjore ndaj tij dhe pas konsultimit me përfaqësuesin e pavarur ligjor.

2. Pala dënuese i jep mundësi Palës zbatuese që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord me palën zbatuese, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara të këtij neni.

#### **Neni 8**

##### **Efektet e transferimit për Palën dënuese**

1. Marrja përsipër e personit të dënuar nga autoritetet e Palës zbatuese ka efektin e suspendimit të ekzekutimit të dënimit në Palën dënuese.

2. Pala dënuese nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse Pala zbatuese e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

**Neni 9**  
**Efektet e transferimit për Palën zbatuese**

1. Autoritetet kompetente të Palës zbatuese duhet të konvertojnë dënimin në procedurë gjyqësore apo administrative, në një vendim të asaj Pale, duke zëvendësuar së këndejmi sanksionin e shqiptuar në Palën dënuese me një sanksion të caktuar me ligjin e Palës zbatuese për veprën e njëjtë, nën kushtet e dhëna në Nenin 10.
2. Ekzekutimi i dënimit do të udhëhiqet sipas ligjit të Palës zbatuese dhe vetëm ajo Palë do të jetë kompetente për të ndërmarë të gjitha vendimet e duhura.

**Neni 10**  
**Konvertimi i dënimit**

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara me ligjin e Palës zbatuese, ndërsa organi kompetent:
  - 1) duhet t'u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato shfaqen qartë dhe shprehimisht nga vendimi i shqiptuar nga Pala dënuese;
  - 2) nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;
  - 3) përcakton periudhën e plotë të heqjes së lirisë të vuajtur nga personi i dënuar; dhe
  - 4) nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i Palës zbatuese për veprën ose veprat e kryera.

**Neni 11**  
**Falja, Amnistia ose zëvendësimi i dënimit**

Secila Palë mund të japë falje, amnisti apo zëvendësim të dënimit në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e saj.

**Neni 12**  
**Rishqyrtimi i vendimit**

Vetëm Pala dënuese ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishqyrtimin e vendimit.

**Neni 13**  
**Përfundimi i Ekzekutimit**

Pala zbatuese përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga Pala dënuese për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënim përfundon të jetë i zbatueshëm..

#### **Neni 14** **Informacioni për ekzekutimin**

1. Pala zbatuese i jep informata Palës dënuese në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

- 1) kur e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;
- 2) nëse personi i dënuar është arratisur nga burgu para se të përfundojë vuajtjen e dënimit; ose
- 3) kur Pala dënuese kërkon një raport të veçantë.

#### **Neni 15** **Gjuha dhe Vërtetimi**

1. Informacionet nën Nenin 4 paragrafi 3, Neni 6 paragrafi 1, 2 do të sigurohen në gjuhën e Palës të cilës i është adresuar, që nënkupton:

- 1) Për Republikën e Kosovës-në gjuhën Shqipe ose Serbe;
- 2) Për Republikën e Maqedonisë-në gjuhën Maqedone.

2. Përveç asaj që është parashikuar në nenin 6. paragrafi 2. pika a, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Marrëveshje nuk nevojitet të vërtetohen.

#### **Neni 16** **Shpenzimet**

Të gjitha shpenzimet e dala në zbatim të kësaj Marrëveshje duhet të mbulohen nga Pala zbatuese, përveç shpenzimeve të dala ekskluzivisht në territorin e Palës dënuese. Shpenzimet në lidhje me transportimin e personit të dënuar duhet të mbulohen nga Pala dënuese, përveç nëse Palët pajtohen ndryshe në ndonjë rast specifik.

#### **Neni 17** **Zbatimi në kohë**

Kjo Marrëveshje do të jetë e aplikueshme për zbatimin e dënimeve të shqiptuara edhe para se kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

#### **Neni 18** **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Gjatë implementimit të dispozitave të kësaj Marrëveshje në raste të mosmarrëveshjes, e njëjta do të zgjidhet me mjete diplomatike.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi dhe përfundimi**


1. Kjo Marrëveshje hynë në fuqi pas kalimit të tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i fundit të Notes me të cilën Palët kontraktuese njoftojnë njëra tjetrën lidhur me procedurën e ratifikimit të udhëhequr ne pajtim me ligjin e brendshëm.

2. Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një kohë të pacaktuar. Secila Palë kontraktuese mundet që me shkrim të ndërpres Marrëveshjen, përmes kanaleve diplomatike. Në rast të tillë, Marrëveshja pushon së vepruari 6 muaj pas datës së njoftimit të tillë.

3 .Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Protokollin e Përkohshëm për Transferimin e Personave të Dënuar në mes të UNMIK-ut dhe Republikës së Maqedonisë, e arritur më 12 Nëntor 2004, pushon së vepruari.

E bëre në Prishtinë më 8 prill 2011 në dy kopje origjinale, në gjuhën Shqipe, Maqedone dhe Angleze, të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast të ndonjë dallimi në përkthim, versioni në gjuhën Angleze do të ketë përparësi.

PËR  
QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



PËR  
QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

